

VENDIM
Nr. 79/2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË AUDITUESVE LIGJORË TË PAVARUR
QË DO TË BËJNË AUDITIMIN E LLOGARIVE FINANCIARE
PËR VITET 2024–2025 TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHETIT

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me propozimin e Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së audituesve ligjorë të pavarur, që do të bëjnë auditimin e llogarive financiare për vitet 2024–2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si më poshtë:

- Edlira Buzani;
- Rajmonda Reveli.

2. Raporti i auditimit i përgatitur nga grupi i audituesve i përcillet Kuvendit brenda tre muajve nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Pagesa e audituesve ligjorë të pavarur mbulohet nga fondet buxhetore të Kuvendit dhe caktohet në masën e tre pagave mujore 100 për qind të pagës së këshilltarit të komisioneve të përhershme të Kuvendit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 8.5.2026.